

Mbi Auditimin Tematik të Ushtruar në Muzeun Kombëtar “Gjergj Kastrioti Skënderbeu”, Krujë

Auditimi u ushtua nga grupi i Auditimit pranë Departamentit të Auditimit të Buxhetit Qendror, Administratës së Lartë Publike, Menaxhimit Financiar dhe Auditimit të Brendshëm të KLSH

Raporti Përfundimtar i Auditimit Tematik: “Për zbatimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë ekonomiko-financiare” të ushtuar në Muzeun Kombëtar “Gjergj Kastrioti Skënderbeu” Krujë për periudhën nga auditimi i fundit deri më datë 28.02.2014 dhe **Rekomandimet janë miratuar me Vendimin nr.47 datë 30.04.2014 (nr. 231/5 prot. datë 30.04.2014 të Kryetarit të KLSH.**

Auditimi Tematik u realizua nga grupi i auditimit: Muhamed Kavaja (përgjegjës Grupi) Marola Lleshi dhe Andrea Kristo Anëtarë.

Kontrolli i Lartë i Shtetit ka rekomanduar dhe kërkuar zbatimin e masave të mëposhtme

1. Nga auditimi i kryer në Muzeun kombëtar “Gjergj Kastrioti Skënderbeu” Krujë, rezulton se procesi i menaxhimit të krijimit të të ardhurave nga Muzeu, konkretisht (prerja e biletave), përfshirja e cilitdo punonjësi në prerjen e biletave administrimin e të ardhurave prej tyre dhe mungesa e një sistemi elektronik i cili të mund të regjistronte hyrjet dhe daljet e çdo vizitori të Muzeut, ka ngritur një sistem lehtësisht abuzues dhe jashtë çdo sistemi kontrolli për këtë qëllim ju rekomandua Ministrisë së Kulturës që në bashkëpunim me Muzeun “Gjergj Kastrioti Skënderbeu Krujë” të marrë masa të menjëhershme për të planifikuar fonde për investime me qëllim instalimin e një sistemi elektronik i cili të mund të regjistrojë hyrjet dhe daljet e çdo vizitori në Muze për rakordimin e biletave të prera me numrin e vizitorëve që hyjnë, veprim i cili do mbyllë çdo shteg që lejon evazion për të ardhurat.

2-Nga auditimi dhe verifikimi i njëpasnjëshëm i të gjithë mandat arkëtimeve të prera dhe të pasqyruara në ditar u konstatua se, në dy mandat arkëtime të nënshkruara nga financieri dhe arkëtari, nuk janë pasqyruar në librin e arkës , Këto veprime tregojnë se, të ardhurat e realizuara janë pasqyruar dhe derdhur në bankë, për më pak në vlerën prej 105,000 lekë, për këtë arsye nga KLSH është rekomanduar shpërblimi i dëmit prej 105,000 lekë nga personat përgjegjës M.N dhe R.T.

3. Në bazë të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Për Kodin e Punës” i ndryshuar”, për personat të cilët janë ngarkuar me përgjegjësi, në Raportin Përfundimtar të Auditimit, i është rekomanduar Ministrisë së Kulturës të bëjë vlerësimin dhe dhënien e masave disiplinore në raport me shkeljet e konstatuara.

KONTROLI I LARTË I SHTETIT